

# AKT THEMELIMI

## I

### SHOQERISE "SHOQERIA E SIGURIMEVE ATLANTIK" SH.A



që përbëjnë:

1. **Dritan Celaj**, i biri i Rrapos, lindur ne Berat ,me 27 Gusht 1968 banues ne Vlore ,  
Lagja " Pavarsia" nr.107, me numer Leternjoftimi
2. **Dervish Haskaj**, i biri i Ademit, Lindur ne Tepelene, me date 8 Mars 1944 ,banues ne  
Tirane ,ne adresen Lagja Nr 2 ,Rr. Arkitekt Kasemi , Pall 1 ,shkalla I Ap. 9
3. **Robert Dako** , i biri i Rekos , Lindur ne Tirane , me 24 Shkurt 1957 ,banues ne  
Tirane " Rruga Lord Bajron" Pall nr 53 / 8 , me nr leternjoftimi 0372068
4. **Merita Aliu** , e bija e Xhelalit, lindur ne Tirane ,me 5 Janar 1969,banuese ne Lagja  
10,Rr. Bajram Curri ,Nr 496

Te siperpermendurit merren vesh sa vijon:

#### Neni 1

Sot me date 3 . 04 2000 vendosem te themelojme shoqerine anonime  
"SHOQERIA E SIGURIMEVE ATLANTIK" sh.a.

#### Neni 2

Kjo shoqeri do te kete seline ne Republiken e Shqiperise ne qytetin e Tiranes ne adresen :  
Rruga " BASHA KOSTRIDI" ,  
PERBALL. B.BOTROR - TIRANE . Selia e shoqerise mund te  
ndryshoj ne perputhje me rregullat e vena nga asambleja ne statutin e saj.

#### Neni 3

Dritan Celaj

Dervish Haskaj

Merita Aliu  
  
Robert Dako

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete e pacaktuar. Duke filluar nga momenti i paisjes me autorizim zyrtar per ushtrimin e veprimtarise nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve. Ne raste se ky autorizim refuzohet, Kryetari i Keshillit Mbikqyres njofton per kete qellim aksioneret, te cilet do te vendosin per shperndarjen e shumave te vendosuara ne kapitalin themeltar, duke caktuar nje likujditor, i cili merr parasyshe shpenzimet qe ka bere shoqeria deri ne kete moment.

#### Neni 4

Na perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet sipas dispozitave te ketij akti themelimi, statutit te saj, ligjit 7638, date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji 8081, date 7.3.1996 " Per Veprimtarite e Sigurimeve dhe te Risigurimeve", Ligjit 8606, date 27.04.2000 " Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin, 8081 date 7.3.1996 dhe aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatim te ligjit, ne fushen e sigurimeve dhe te risigurimeve.

#### OBJEKTI

#### Neni 5

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj : Sigurimin e demeve ne perputhje me ligjin 8081 date 7.03.1996 "Per Veprimtarite e Sigurimeve dhe Risigurimeve", si dhe operacionet qe rrjedhin drejtperdrejt nga kjo veprimtari.

#### KAPITALI THEMELTAR

#### Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100,000.000(njeqindmiljon) leke, i cili do te jete i teri ne mjete monetare. Eshte i ndare ne 10.000 ( dhjetemije) aksione nominative te themeluesve te shoqerise, te cilet jane te se njejtës kategori, me vlere nominale prej 10.000 ( dhjetemije) leke per cdo aksion. Aksionet jane te numeruara nga nje deri ne dhjete mije, perfshire numrin e fundit te aksionit. Ne baze te kontributit, aksioneri i pare, Dritan Cela, do te kete aksionet nga numri 1 (nje) deri ne numrin 9.000 (nente mije), aksioneri i dyte, Dervish Haskaj, do te kete aksionet nga numri 9.001( nentemije e nje) deri ne numrin 9.490 (nentemijekaterqindenentedhjete) dhe aksioneri i trete, Robert Dako Zoteron aksionet nga numri 9491(nentemijeekaterqind enentedhjeteenje) deri ne 9800(nentemije eteteqind), aksioneri i katert, Merita Aliu do te kete aksionet nga numri

Dritan Cela  
Chel

Dervish Haskaj  
Haskaj

Merita Aliu  
Aliu  
Robert Dako  
Dako

9.801 (nentemije eteteqindenje) deri ne numrin 10.000 (dhejtemije). Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

Emri e Mbiemri	Perqindja	Nr. i aksioneve	Vlera ne leke
1. Dritan Celaj	90	9.000	90.000.000
2. Dervish Haskaj	4.9	490	4.900.000
3. Robert Dako	3.1	310	3.100.000
4. Merita Aliu	2	200	2.000.000

## ORGANET DREJTUESE

### Neni 7

**Organet drejtuese te shoqerise jane:**

Asambleja e aksionereve  
Keshilli Mbikeqyres  
Drejtoria

Perberja dhe funksionet e organeve te mesiperme drejtuese percaktohet hollesisht ne statutin e shoqerise.

Keshilli Mbikeqyres, brenda pesembedhjete diteve nga paisja me autorizim zyrtar nga organi kompetent, duhet te caktojte drejtorin e pergjithshem. Afati i ushtrimit te veprimtarise se Keshillit Mbikeqyres dhe Drejtorise percaktohet ne statut.

### Neni 8

Shoqerija autorizon Presidentin e Asamblese se Aksionereve z. Dritan CELAJ, te kryej veprimet e regjistrimit te shoqerise ne gjykate, te paraqese kerkesen dhe te perfaqesoje shoqerine ne procesin e licensimit te saj nga Komisioni i Mbikeqyrjes se Sigurimeve

### Neni 9

Kapitali themeltar i shoqerise do te derdhet ne Banken "Banka e Kursimeve" Tirane Ngarkohet Kryetari i Keshillit Mbikeqyres i shoqerise te vertetoje sipas ekstraktit bankare

*Dritan Celaj*

*Dervish Haskaj*

*Merita Aliu*

*Robert Dako*

*Robert Dako*

*Robert Dako*

*Robert Dako*

derdhjen e kapitalit nga sejcili aksioner, si dhe t'u jape vertetime sejcilit per shumat e derdhura. Kapitali themeltar qe duhet te jete i derdhur ne momentin e nenshkrimtit te akteve te themelimit. Shoqerise eshte sa 1/2 e tij, dhe vertetohet se ai eshte derdhur rregullisht nga aksioneret sipas dokumentacionit ngjitur ketij akti themelimi.

#### Neni 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve te saj do te behen ne perputhje me dispozitat e statutit

#### Neni 11

Dispozita me te hollesishme per shoqerine caktohen ne statutin e saj.

Ky dokument firmoset nga aksioneret:

1. DRITAN CELAJ



2. DERVISH HASKAJ



3. ROBERT DAKO



4. MERITA ALIU




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA  
TIRANE, me 27.11. 2000

Nr. 54/Rep  
Nr. 28/Kol

VERTETIM

Me ane te te cilit vertetojme se aksioneret Dritan Celaj, Dervish Haskaj dhe Robert Dato Merita Aliu e nenshkruan aktin e themelimit te shoqerise me vullnetin e te lire dhe ne pranine time. Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.





# STATUT I SHOQERISE ANONIME TE SIGURIMEVE "ATLANTIK" S.H.A

## KAPITULLI I

### FORMA, EMRI, SELIA DHE OBJEKTI

#### Neni 1

##### Forma juridike

Shoqeria formohet ne formen e shoqerise anonime dhe do te funksionoje ne perputhje me dispozitate ligjit nr 7638, date, 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" te ligjit 8081, date, 7.06.1996 "Per veprimtarite e Sigurimit dhe te Risigurimit", akteve te tjera qe rregullojne veprimtarine e sigurimeve dhe sipas ketij statuti e aktit te themelimit

#### Neni 2

##### Emertimi, selia, kohezgjatja

Emri i plote i shoqerise eshte "Shoqeria e sigurimeve ATLANTIK" S.H.A  
Selia e shoqerise eshte ne Tirane, ne adresen

Rruga "BONIKA KASTRIOTI" PERBALL B. Botrou TIRANE  
Shoqeria ka rrjetin e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise te perbere nga degje dhe zyra te sherhimeve qe ofron shoqeria ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete statut per nje afat kohore te pacaktuar

#### Neni 3

##### Objekti

Shoqeria ka per objekt te saj sigurimin e demeve ne perputhje me ligjin 8081, date 1.03.1996 "Per veprimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve", si dhe edo operacion tjeter qe rrjedh drejtperdrejt nga keto veprimtari.

*Erta Dade*  
*[Signature]*

*Jervis Hoxha*  
*[Signature]*

*Merita Iliri*  
*[Signature]*

*Robert Doko*  
*[Signature]*

## KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

### Neni 4 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000,000 (Njeqindmiljon) Leke.  
Ai eshte i ndare ne 10.000 (dhjetemije) aksione nominale te themelueseve te shoqerise te cilat jane te se njejtës kategori me vlere nominale 10,000 (Dhjetemije) leke per cdo aksion.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri ne 10.000 perfshire numrin e fundit te aksionit. Aksioneri i pare z. Dritan Celaj zoteron aksionet nga numri 1 (nje) deri ne 9.000 ( nente mije), aksioneri i dyte, z. Dervish Haskaj zoteron aksionet nga numri 9.001 ( nente mije e nje) deri ne 9.490 ( nentemije katerqind e nentedhjete), aksioneri i trete, z. Robert Dako zoteron aksionet nga numri 9.491 (nentemije e katerqind e nentedhjeteenje) deri ne 9.800 ( nentemije e teteqind) , aksioneri i katert, Zj. Merita Aliu zoteron aksionet nga numri 9.801 (nentemije e teteqindenje) deri ne 10.000 ( dhjetemije).

Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

Emri Mbiemri	Perqindja	Nr. i aksioneve	Vlera ne leke
Dritan Celaj	90	9.000	90.000.000
Dervish Haskaj	4,9	490	4.900.000
Robert Dako	3,1	310	3.100.000
Merita Aliu	2	200	2.000.000

### Neni 5 Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise munde te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te ligjit Nr 7638, date 10.11.1992 " Per shoqerite tregtare"

Zmadhimi i kapitalit themeltar munde te kryhet vetem me vendim te Asamblese te Jashtezakonshme te Aksionereve, ne baze te raportit te drejtorise, me miratimin paraprak te Komisionit te Mbikeqyrjes se Sigurimeve , i cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparësise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen nga zmadhimi i kapitalit. Kjo e drejte eshte

Dritan Celaj  
CPA

Dervish Haskaj  
D.H.

Merita Aliu  
Robert Dako  
R.D.

perpjestimore me numrin e aksioneve te zoteruara nga seicilli aksioner perpara zmadhimin te kapitalit

Aksioneret munde te heqin dore vefem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata munden gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete

Aksionet qe mbeten te panenshkuara ne menyre te vullneteshme nga nje apo disa aksioner, in afrohen aksionereve te tjere te shoqerise per nenshkrim sipas parimit te perpjestueshmerise ne baze te shumtes se kapitalit qe zoterojne ne momentin e nenshkrimit. Ne qoftese aksionet e panenshkuara nuk pranohen te nenshkruben nga asnje prej aksionereve te shoqerise, procedohet sipas nenit 9(nente) te ketij Statuti.

#### Neni 6

#### Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise kryhet vetem me vendim te asamblesse se jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Zvogelimi i kapitalit nepermjet riblerjes se aksioneve ose te shperndarjes se mjeteve rezerve munde te vendoset vetem pasi te jete marre paraprakisht autorizimi me shkrim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve

Shoqeria nuk munde te beje shperndarje kapitali nese sipas legjislacionit ne fuqi, pas shperndarjes do ti mbetet me pak se kapitali minimum i detyrueshem

#### Neni 7

#### Shlyerja e aksioneve

Aksionet ne para te nenshkuara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen te pakten 1/2 (gjysmes) se vleres se tyre qe ne momentin e nenshkrimit. Pjesa tjetere e vleres do te shlyhet me nje ose dy keste ne nje afat kohore te vendosur nga asambleja ne perputhje me rregullat e licensimit nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve

Asambleja e jashtezakonshme qe vendose zmadhimin e kapitalit ka te drejte te marre nje vendim per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne momentin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurtër nga ai i permendur ne paragrafin e pare te ketij neni

Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkrueseve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per edo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar edo titullari te aksioneve

Dritan Celaj  
C. Celaj

Denis Hoxha  
D. Hoxha

Menta Alin  
M. Alin

Robert Daka  
R. Daka





## Neni 8 Forma e aksioneve

Aksionet e shoqerise jane te formes nominative.  
Pronesia e aksioneve vertetohet nga rregjistrimi i tyre ne emer te pronarit ne regjistrin e mbajtur per kete qellim nga shoqeria, ne kushtet dhe sipas menyrave te parashikuara nga ligji.  
Shoqeria i leshon atij nje vertetim te regjistrimit te aksioneve ne pronesi te tij

## Neni 9 Shitja dhe transferimi i aksioneve

Pervec rastit te trashegimise transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi joaksionar , pamvaresisht nga baza juridike e ketij transferimi , duhet te miratohet nga keshilli mbikeqyres ne kushtet dhe sipas procedurave te parashikuara nga neni 207 i ligjit per shoqerite tregtare.

Ne transferimin e pronesise se aksioneve te shoqerise nje personi fizik ose juridik,aksioner ose jo, do te respektohen procedurat e parashikuara nga ligji 8081 dt.07.03 1996 " Per verpimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve" neni 27 i tij

Neqoftese per vleresimin e aksioneve ka vend per ekspertize , shpenzimet per kete perballohen gjysma nga shitesi dhe gjysma nga blesesi.

## Neni 10 Pandashmeria e aksioneve

Aksionet jane te pandashme perkundrejt shoqerise.  
Bashkepronaret e aksioneve jane te detyruar te perfaqesohen perpara shoqerise, nga njeri prej tyre , i konsideruar si pronar i vetem, ose nga nje perfaqesues i vetem i zgjedhur nga bashkepronaret . Ne rast mosmarreshijeje perfaqesuesi mund te caktohet nga gjykata me kerkesen e bashkepronarit qe e merr i pari kete nisme

## Neni 11

### Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Aksionet i japin pronarit te tyre te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shperndashme vjetore te shoqerise dhe ne tepricat e aktivitet te mbetur ne rastin e nje likuidimi, ne nje pjese perpjestimore me kuoten e kapitalit qe perfaqeson aksioni.Cdo aksion jep te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne asamblete e zakonshme ne kushtet ligjore dhe statutore.

Aksioneret jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masesh shumesh nominale te aksioneve qe zoterojne .Cdo kerkim i fondeve pertej kesaj shume eshte i ndaluar

Dr. Anton Celaj

Chelaj

Dervish Hoxhaj

Hoxhaj

Merita Alushi

Robert Doka

Doka

Te drejtat dhe detyrimet ne lidhje me aksionin e ndjekin kete aksion ne cfardo dore qe kalon Pronesia e nje aksioni permban te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se zakonshme

### KAPITULLI III

## DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

### Keshilli i Mbikqyrjes

#### Neni 12

#### Perberja dhe emerimi

Shoqeria drejtohet nga nje Keshill Mbikqyrjeje qe perbehet nga 3 ( tre) anetar. Anetaret e pare te keshillit mbikqyrjes jane

- |                        |            |
|------------------------|------------|
| 1. Dritan Rrapo Celaj  | Kryetar    |
| 2. Edmond Kadri Spahiu | Zv Kryetar |
| 3. Dervish Adem Haskaj | Anetar     |

Anetaret e keshillit mbikeqyrjes emerohen nga mbledhja e pergjitheshme e zakonshme e aksionereve per nje kohe prej 3 vjet. Ne emerimin e anetareve te Keshillit te Mbikeqyrjes respektohen papajtueshmeria apo ndalesat ligjore.

Funksionet e anetareve te Keshillit Mbikeqyrjes perfundojne normalisht ne mbarimin te mbledhjes se zakonshme te aksionereve qe vendos per llogarite e ushtrimit te mbyllur e mbajtur ne vitin gjate te cilit mbaron mandati i tyre

Anetaret e Keshillit te Mbikeqyrjes jane te rizgjedhshem.

Ata munde te shkarkohen ne cdo kohe nga mbledhja e zakonshme e aksionereve

#### Neni 13

#### Anetaret e Keshillit te Mbikeqyrjes persona juridik

Nje person juridik, qe eshte aksioner i shoqerise, mund te jete anetar i keshillit mbikeqyrjes. Ne kete rast ky duhet te caktoj qysh ne castin e zgjedhjes, nje perfaqesues te perhershem person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrime dhe ka te njejtat pergjegjesi civile e penale sikur te ishte ai vete anetar i keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson.

Neqoftese personi juridik ia heq mandatin perfaqesuesit te tij duhet te njoftoje per kete shoqerine menjehere dhe te beje njokohesisht zevendesimin e tij. Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqesuesit te perhershem

Dritan Celaj

Upd

Dervish Haskaj

Upd

Merita Alai

Upd

Robert Doko

Upd

#### Neni 14

#### Vendet bosh ne keshillin e mbikeqyrjes

Neqoftese nje ose disa vende ne keshillin e mbikeqyrjes mbeten bosh midis dy mbledhjeve te zakonshme te aksionereve, si rrjedhoje e vdekjes apo doreheqjes, keshilli i mbikeqyrjes mund te beje nje ose disa emerime te perkoheshme. Emerimi i anetareve nga vete keshilli duhet te ratifikohet nga mbledhja e pergjithshme me e afert e asamblese.

#### Neni 15

#### Kryetari i keshillit te mbikeqyrjes

Kryetari i Keshillit te Mbikeqyrjes emerohet nga asambleja e zakonshme e aksionereve, midis anetareve te tij dhe ngarkohet te mbledhe keshillin dhe te drejtoje debatet gjate seancave te tij. Ai ushtron funksionet e tij gjate tere periudhes se mandatit si anetar te keshillit mbikeqyres.

Keshilli mbikeqyres munde te emeruje, gjithashtu, nje sekretar qofte edhe jashte anetareve te tij, duke caktuar edhe kohezgjatjen e funksioneve te ketij Kryetari dhe sekretari i keshillit jane te rizgjedhshem.

#### Neni 16

#### Mbledhja e keshillit te mbikeqyrjes

Keshilli i Mbikeqyrjes eshte organ kolegjal, pergjegjes, dhe mbikeqyres per shoqerine. Ai ben shqyrtim dhe merr vendime vetem nepermjet mbledhjeve te tij

Keshilli mbikeqyres mblidhet nje here ne muaj dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise. Ai mblidhet gjithashtu ne fund te cdo tremujori per te degjuar raportin e drejtorit te pergjithshem. Mbledhja thirret nga kryetari dhe ne mungese te tij, nga anetaret e tjere te keshillit.

Kryetari dhe, ne mungese te tij, njeri nga anetaret duhet te therrasin mbledhjen e keshillit brenda 15 ditesh kur nje e treta e anetareve te keshillit i paraqesin atij nje kerkese te arsyeshme per kete. Neqoftese kerkeses nuk i jepet rruge, autoret e saj munde te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes te keshillit te mbikeqyrjes duke treguar rendin e dites se mbledhjes.

Mbledhjet e keshillit te mbikeqyrjes mbahen ne seline e shoqerise. Si rregull njoftimi per mbledhjen duhet t'u dergohet anetareve te keshillit pese dite perpara me leter, telegram ose forme tjeter e shkruar komunikimi

*Dritan Lela*

*CH*

*Lewis Heskay*

*Merita Alis*

*Robert Dake*

*Du Hal*

Cdo thirrje duhet te permbaje ceshtjet kryesore te rendit te dites si dhe materjalet qe do te diskutohen. Mbledhja e keshillit drejtohet nga kryetari dhe, ne mungese te tij, nga zv.kryetari.

#### Neni 17

#### Vendimet e keshillit mbikeqyres dokumentimi i vendimeve

Keshilli merr vendime te vlefshme kur ne mbledhjen e tij jane me shume se gjysma e anetareve ne funksion. Cdo anetar i keshillit mund t'i jape mandat perfaqesimi ne mbledhjen e keshillit nje anetari tjetër. Cdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten mbledhje. Anetari i perfaqesuar nuk merret parasyshe ne quorumin e perfaqesimit, sic percaktohet me siper.

Vendimi merret me shumicen e votave te anetareve te pranishem ose te perfaqesuar. Cdo anetar i keshillit ka vetem nje vote dhe nuk mund te perfaqesoje me shume se nje anetar tjetër.

Kur keshilli mbikeqyres eshte mbledhur per te vendosur mbi nje projekt te shitjes se aksioneve nje te treti joaksioner ne kushtet e parashikuara ne nenin 9 te ketij statuti, vendimi i miratimit merret me shumicen e dy te tretave te votave te anetareve te pranishem ose te perfaqesuar. Neqoftese shitesi i aksioneve eshte anetar i keshillit mbikeqyres ai nuk merr pjese ne votim.

Ne rast te votave te barabarta ajo e kryetarit te seances eshte percaktuese.

#### Neni 18

Keshilli i mbikeqyrjes mbane nje liber te pranise i cili firmoset nga anetaret pjesmarres ne mbledhje

Justifikimi i anetareve ne funksion dhe i emerimit te tyre provohet ne menyre te vlefshme ndaj te tretteve vetem nga tregimi ne proceverbalin e cdo mbledhjeje te emrave te anetareve te pranishem, te perfaqesuar ose te munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikeqyres evidentohen me ane te procesverbaleve te mbajtura ne nje liber te posacem ( protokoll) , i numeruar dhe i vulosur, qe mbahet ne seline qendrore te shoqerise ne te cilin tregohen, vec te tjerash, anetaret e pranishem, te perfaqesuar dhe te munguar si dhe cdo person tjetër qe ka asistuar ne mbledhjen e keshillit, teresisht ose pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga kryetari i seances, sekretari i keshillit dhe te pakten nga nje anetar i keshillit.

*Dr. Arben Ceku*

*Urd*

*Derwish Hoxha*

*Urd*

*Merita Alia*

*Urd*

*Robert Dako*

*Dako*

## Neni 19

### Kompetencat e keshillit te mbikeqyrjes

Keshilli i mbikeqyrjes ushtron ato kompetenca te cilat jane te parashikuara ne ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ,seksioni i shoqerive anonime, me perjashtim te kopetencave qe ligji dhe ky statut ia kane rezervur asamblese se pergjitheshme te aksionereve ose drejtorit te pergjitheshem.

Jane ne kopetence vetem te keshillit te mbikeqyrjes aktet dhe operacionet e renditura me poshte:

1. Miratimi i rregulloreve te brendeshme te shoqerise qe percaktojne:

- a) Strukturen e organizimit dhe administrimit te shoqerise, duke perfshire dhe njesite funksionale dhe administrative te saj, pozicionet mbikqyrese dhe marredhenjet raportuese.
- b) Detyrat e cdo drejtori departamenti dhe njesive qe ai drejton dhe ka ne vartesi
- c) Funkcionet e komitetit te kontrollit te brendeshem dhe funksionet e komiteteve te tjera te ngritura nga keshilli mbikeqyres.
- d) Rregulla per administrimin e shpenzimeve te shoqerise.

2. Miratimi dhe mbikqyrja e politikese se shoqerise per:

- a) Llojet, kushtet, afatet dhe primet e policave te sigurimit.
- b) Kushtet dhe kriteret sipas te cilave shoqeria munde te negocioje me institucione financiare per te marre hua si dhe kufijt e huamarrjes
- c) Zgjerimin e veprimtarise se shoqerise me produkte te reja brenda kufijeve te caktuar ne autorizimin zyrtar te leshuar nga Komisioni i Mbikeqyrjes se Sigurimeve.

3. Miratimi i numrit te pergjitheshem te personelit te shoqerise, i kriterëve te marrjes ne pune te personelit teknik , i tabelës se pagave dhe i kriterëve per dhenjen e shperblimeve suplementare

4. Pergatitja dhe paraqitja per shqyrtim ne mbledhjen e aksionereve te gjendjeve financiare vjetore dhe te raportit te veprimtarise.

5. Thirrja e asamblese se pergjitheshme sa here kjo eshte e nevojshme dhe ne mbyllje te vitit financiar per te miratuar gjendjen financiare vjetore

6. Shkarkon dhe emerom drejtorin e pergjithshem te shoqerise

7. Keshilli mbikeqyres ka te drete te operoj me urdhera me qellim permiresimi te praktikes se punes se drejtorise. Urdherat e keshillit jane te detyrueshme per drejtorine

Britan Celaj  
QR

Dervis Haskaj

Merita Alen

Robert Datto  
Datto

**Neni 19 /1**  
**Marreveshje qe kerkojne autorizim**

Marreveshje qe kerkojne autorizim paraprak te Keshillit Mbikeqyres jane:

- Te gjitha marreveshjet qe behen ndermjet shoqerise dhe nje anetari te Drejtorise apo te Keshillit Mbikeqyres te saj.
- Marreveshjet me te cilat nje nga personat e siperpermendur lidhet indirekt ,apo me te cilet ai lidhet me shoqerine nepermjet nje personi ndermjetes
- Marreveshjet qe veprojne ndermjet shoqerise dhe nje subjekti tjeter ekonomik te nje lloji te cfaredoshem, ne raste se nje nga anetaret e Drejtorise apo te Keshillit Mbikeqyres te shoqerise eshte pronar,ortak i pakufizuar,administrator apo anetar i drejtorise te subjektit tjeter ekonomik.

Rregullat e ketij neni nuk zbatohen per operacionet e perditeshme dhe te zbatuara ne kushte normale.

**Neni 20**

**Informimi i anetareve te keshillit**

Anetaret e keshillit mbikeqyres kane te drejte te kerkojne dhe te marrin informacion nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise per ceshtje te natyres teknike administrative dhe financiare. Kryetari i keshillit mbikeqyres ka pergjegjesine per t'i vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

- Shoqeria nuk eshte e detyruar t'u jape anetareve te keshillit kopje te procesverbaleve te vendimeve te keshillit, por cdo anetar munde te kerkoje te njihet me to ne seline e saj.
- Mosnjohja e te drejtave te cdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mosthirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerine e vendimeve te keshilli.

**Neni 21**

**Pergjegjesite e anetareve te keshillit mbikeqyres**

Anetaret e keshillit mbikeqyres mbajne pergjegjesi civile solidarisht dhe individualisht ,sipas rastit, ndaj te treteve dhe ndaj shoqerise per shkeljet e dispozitave ligjore ose te rregullimeve te zbatueshme per veprimtarine e shoqerise, per shkelje te statutit , si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise per shkak te vendimeve te tyre

Pergjegjesia penale e anetareve te keshillit mbikeqyres percaktohet ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

*Ortun Çelaj*  
*[Signature]*

*Denis Hoxhaj*  
*[Signature]*  
*Merita Alia*  
*[Signature]*  
*Robert Doko*  
*[Signature]*

## Neni 22

### Shperblimet vecante dhe shperblimet e jashtezakoneshme te anetareve te keshillit mbikqyres

Anetaret e keshillit perfitojne shperblim vjetor te pandryshueshem, masen e ketij shperblimi percakton asambleja e zakonshme, masa e shperblimit mberet e pandryshueshme deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Per anetaret te cilet caktohen me misione apo qe kane marre mandate per sherbime apo detyra te caktuara, keshilli i mbikqyrjes cakton shperblim suplementar.

Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakoneshme perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzime te saj.

## Drejtori i pergjithshem ,dhe drejtuesit teknik

### Neni 23

#### Drejtoria

Drejtimi i pergjithshem i shoqerise behet nga drejtoria, e cila perbehet nga nje anetar i cili ka detyren e drejtorit te pergjithshem dhe eshte pajeter person fizik. Anetaret e drejtorise zgjidhen nga keshilli mbikqyres

Drejtori i Pergjithshem i shoqerise emerohet nga Keshilli i Mbikqyrjes brenda 15 diteve nga pajsja me autorizimin zyrtar nga autoriteti kompetent. Mandati i funksionimit te tij eshte 4 vjet

Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marrredhenjet me te tretet me kopetenca te plota ne kufijt e objektit te saj, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia ka caktuar shprehimisht asamblese se pergjithshme te aksionereve dhe kompetencave te specifikuara te keshillit te mbikqyrjes.

Drejtori i pergjithshem mund ti delegoje nje pjese te kompetencave te tij tek persona te tjere. Ne kete rast mban pergjegjesi vete perpara shoqerise per demet qe mund t'i vine asaj nga veprimi i personave te cileve ju jane deleguar kompetencat sipas parashikimeve te ketij paragrafi.

### Neni 24

#### Zevendesimi i perkohshem i drejtorit te pergjithshem

Kur drejtori i pergjithshem

*Edi Haxhiu*  
*CH*

*Denise Hedonj*  
*CH*

*Merita Aliu*  
*Merita*  
*Robert Dako*  
*Dako*

1. per arsye të një semundjeje të zgjatur ose një ngjarjeje tjetër të papritur pengohet për të kryer funksionet e tij.
2. jep dorëheqjen ose vdes dhe nuk është e mundur të bëhet menjëherë emerimi i drejtorit të rr.

Keshilli mbikqyres cakton një anëtar të tij që ta zëvendësojë atë për kohësisht në të gjitha funksionet e tij.

#### Neni 24/ 1

Shoqëria i bën të ditur Komisionit të Mbikqyrjes së Sigurimeve çdo ndryshim të titullarit që i përket funksionit të presidentit, drejtorit të përgjithshëm ose drejtorëve teknik

24/2

Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtoret teknik janë solidarisht ose individualisht përgjegjës sipas rastit, për demet që i shkaktohen shoqërisë dhe të tjerëve nga masat që merr Komisioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve, për shkeljet që konstatohen nga ai si pasojë e ushtrimit të kontrollit në përputhje me Kreun IV seksinet II dhe III të Ligjit nr. 8081.

#### Neni 25

#### Drejtoret teknik

Drejtoret teknik janë të punësuar të shoqërisë të cilët emërohen unanimisht nga drejtori i përgjithshëm dhe kryetari i keshillit mbikqyres, të cilët përcakton edhe funksionet e tyre, në pajtim me rregulloren e shoqërisë të miratuar nga keshilli i mbikqyrjes.

Drejtoret teknik nuk kanë asnjë kompetencë për ta angazhuar shoqërinë ndaj të tjerëve, përveç rastit kur drejtori i përgjithshëm u ka deleguar atyre me mandat një pjesë të kompetencave të tij

Erilan Celaj

Yur

Deris Hoxhaj

Yur

Merita Aliaj

Robert Dato



## Neni 26

### Kopetencat e drejtorit te pergjithshem

Drejtori i Pergjithshem ushtron te gjitha kopetencat qe nuk i ka Asambleja e Aksionereve dhe Keshilli Mbikqyres, si dhe eshte i vetmi person qe perfaqeson personalitetin juridik te shoqerise.

## Neni 27

### Operacionet e drejtorise me miratim paraprak

Drejtoria detyrohet te kerkoje autorizim paraprak nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres per:

- a) Bankat ne te cilat shoqeria do te vendose mjetet monetare prone e saj dhe ne administrim.
- b) Celja e llogarive bankare ne emer te shoqerise behet vetem ne bankat e percaktuara sipas pikes a.
- c) Devizjet e vlerave monetare per efekt pagese, qe per nje afat kohor dhjete ditor te jalojne shumen e 10 (dhjete) milion leke.
- d) Vendin e prodhimit, sasine dhe numrat rendor, formen dhe rregullat e administrimit te policave te sigurimit.
- e) Kontraten tip te agjentit dhe emerimin e agjenteve te vecante.
- f) Per percaktimin e ofertes me te mire te risigurimit dhe per lidhjen e kontrates me risiguresit ose ndermjetesat e risigurimit.
- g) Krijimin e garancive me ane te pasurise se shoqerise.
- h) Kryerjen e investimeve qe nuk perfshihen ne programin vjetor financiar.
- i) Celjen e veprimtarive, degeve apo agjensive te reja.
- j) Shkrijjen, bashkimin dhe mbylljen teresisht ose pjeserisht te veprimtarive ose degeve te shoqerise.
- k) Pjesmarrjen ne shoqeri te tjera sigurimesh ose risigurimesh, te krijuara ose qe do te krijohen.
- l) Shitjen dhe shkembimin e pasurive qe perbejne aktiv te qendrueshem te shoqerise
- m) Rrugen qe duhet te marre cdo praktike qe duhet ndjekur pas ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, per likuidimin ose jo te demit, por gjithmone pas shqyrtimit paraprak te praktikave nga specialistet perkates dhe Drejtori i Pergjithshem.

## Neni 28

### Veprimet me llogarite e shoqerise

Veprimtarite me llogarite e shoqerise ne banka dhe ne arken e saj behen me dy firma njekohesisht (firma e pare dhe firme e dyte), per shumat deri ne 1.500.000 (nje milion e pesqind mije) leke firmosen nga Drejtori I Pergjithshem si firme e pare, dhe personi I autorizuar nga Kryetari I Keshillit Mbikqyres si firme e dyte. Levizien e mieteve

Dritan Colaj  
CH

Jensiss Herbex  
Ruf.

Merita Almi  
Robert Duka  
Bata

monetare per efekt pagese te cdo lloji e cila tejkalon 1.500.000 (njemilione peseqindmije) leke, kerkon detyrimisht firmosjen nga kryetari. Per kete kateqori pagesash behet depozitimi i firmes se Kryetarit te Keshillit te Mbikqyrjes ne banke, si firm e pare.

## Kontrolli i pavarur ( Eksperti kontabel i autorizuar)

### Neni 29 Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e zakonshme cakton nje kontrollor te pavarur, te zgjedhur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ekspert kontabel i shoqerise do te jete Miranda Rrapi Demaj  
Kontrollori i pavarur caktohet per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar

Shperblimi i ekspertit kontabel te pamvarur caktohet nga Asambleja e Pergjithshme e aksionereve dhe perballohet nga shoqeria.

### Neni 30

### Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrollorit te pamvarur te shoqerise jane ato qe parashikohen nga ligji "Per shoqerite tregtare", dhe nga aktet e tjera ne fuqi qe rregullojne kete profesion



## KAPITULLI IV

## ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

### Neni 31

### Natyra e asamblese dhe karakteri detyrues i vendimeve

Sipas natyre per te cilar thirren asamblete e aksionereve cilesohen asamble te zakonshme dhe te jashtezakonshme.

*Erivan Cday*  
*[Signature]*

*Demis Haslag*  
*[Signature]*

*Merita Heli*  
*[Signature]*  
*Robert Doko*  
*[Signature]*

Cdo asamble e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese detyrojne te gjith aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder

### Neni 32

#### Thirrja e asamblese, rendi i dites

Asamblete thirren nga keshilli mbikeqyres ose nga drejtoria. Ato mund te thirren gjithashtu, nga kontrollori i pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmabajtes i caktuar nga gjykata dhe, kur eshte rasti, nga likujduesi.

Asamblete mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne dore te aksionerit 15 dite perpara mbledhjes dhe duhet te permbaje diten, oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te siguroi quorumin dhe per rrjelloje nuk ka mundur te marre vendime, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si me pare. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne daten dhe rendin e dites.

Rendi i detes se mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Nje ose disa aksioner qe perfaqesojne te pakten 5 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejte te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe arsyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te kerkuar si me siper

Projektrezolutat dhe dokumentat shoqeruese duhet te mberrijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dites se mbledhjes se asamblese

Rendi i dites se mbledhjes se asamblese nuk munde te ndryshoje me nje njoftim te dyte

Ermitan Celaj  
GPH

Dimitër Hoxha  
Dy

Merita Alia  
Mery  
Robert Daka  
Bash

**Neni 33**  
**Pjesmarrja ne asamble**

Pamvarësisht nga numri i aksioneve qe zoteron, cdo aksioner, ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme dhe ne vendimet e saj, personalisht apo nepermjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit si dhe te regjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te shoqerise.

Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese vetem nga bashkeshorti ose nje aksioner tjetër. Per kete qellim perfaqesuesi duhet te paiset nga aksioneri me mandat te posacem , ne kushtet e parashikuara nga ligji.

**Neni 34**

**Evidenca e pjesmarrjes ,drejtimi i mbledhjes dhe proces verbalet**

Per cdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete pranie e cila permban treguesit qe praxojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flet-prania firmoset ne ane nga aksioneri, kur eshte rasti, nga perfaqesuesi i tij ,dhe veretohet per saktesine e saj nga Komisioni vezhgues i mbledhjes.

Mbledhja e asamblese drejtohet nga kryetari i saj, i cili eshte i zgjedhshem ne cdo mbledhje nga vete aksioneret me perqindjen e thjeshte te votave te aksionereve pjesmarres ne mbledhje.

Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga kontraktori i pamvarur, mandatmbajtesi i caktuar nga gjykata apo, likujduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Per cdo mbledhje te asamblese hartohet nje procesverbal i cili permban daten dhe vendin e mbledhjes  
menyren e thirrjes  
rendin e dites  
drejtuesin e mbledhjes dhe komisionin e vezhgimit  
numri i aksioneve qe marrin pjese ne votim  
quorumi i arritur  
permendjen e dokumenteve dhe raporteve qe jane shtruar ne mbledhje  
nje permbledhje te debateve  
tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret  
Rezultatet e votimit

*Enxhin C. Gaj*

*[Signature]*

*Demir Hotaj*

*[Signature]*

*Merta Alin*

*Robert Dako*

*[Signature]*

Proceverballet e mbledhjeve te asamblese hartohen ne nje regjister te posacem, i numeruar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

### Neni 35

#### Quorumi, votimi, numri i votave

Quorumi llogaritet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Cdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote.

Kur aksionet e shoqerise zoterohen nga nje ose disa persona juridik ne te cilet shoqeria ka drejperdrejt ose terthorazi kontrollin, e drejta e votes se aksioneve te personave juridik nuk munde te jete me shume se 10 per qind e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Votimi kryhet me doren ngritur me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese. Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.

### Neni 36

#### Asamblete e zakonshme

Asambleja e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur

Ajo ka, midis te tjerash, kompetencat qe vijojne:

Te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise

Te miratoje programin financiar vjetor

Te miratoje, ndryshoje ose hedh poshte llogarite vjetore te paraqitura per miratim

Te vendos per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe statutin.

Te emeroje dhe shkarkoje anetaret e keshillit mbikqyres

Te emeroje ekspertin kontabel te autorizuar

Te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te keshillit mbikqyres te kryera

Dritan Celaj  
Ylli  
Dervis Hoxhaj  
Merita Alu  
Maur  
Robert Dako  
Dako

nga vete keshilli si emerime te perkohshme

Te mirateje pagen e drejtorit te pergjithshem dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te shoqerise , si dhe shperblimet suplementare qe munde te jepen per pune ose rezultate te mira.

Te caktoje shperblimin e vecante dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per keshillin mbikqyres.

Te vendose per raportin e kontrollorit te pavarur lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit mbikqyrs.

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshime ne statut.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

### Neni 37

#### Asambleja e jashtzakonshme

Asambleja e jashtzakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti. Per ndryshimet ne statut merret miratimi paraprak nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve

Ajo nuk munde te ndryshoje detyrimet e aksionereve pervec operationeve qe rrjedhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregillisht.

Asambleja e jashtzakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 2/3 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky quorum eshte jo me pak se 1/3 e aksioneve me te drejte vote. Vendimet e asamblese se jashtzakonshme merren me shumicen prej 2/3 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar

Gjritan Celaj

Celaj

Dervish Hoxhaj

Hoxhaj

Merita Aliu

Aliu

Robert Daka

Daka

## Neni 38

### Ndarja e fitimit neto

#### Fitimi neto i shoqerise perdoret si vijon:

Per rezerven e e nevojshme per te plotesuar minimumin e fondit te garancise sipas percaktimit ne ligjin 808 i " Per veprimtarite e sigurimeve dhe te risigurimeve"  
Per rezerva te tjera te nevojshme  
Per dividend

Fitimet e shoqerise nuk munde te caktohen per shperblime apo perfitime te tjera te personelit, per sponsorizime apo dhurime dhe asa per ndonje qellim tjeter qe ka natyre shpenzimi dhe hyn ne koston e shoqerise.

## Neni 39

### Dividentet

Fitimi I shperndashem si dividend perbehet nga fitimi neto I vitit financiar I pakesuar me humbjet e mbartura dhe me rezervat e hequra ne zbatim te statutit dhe I shtuar nga fitimet e mbartura. Fitimi I shperndashem ndahet midis te gjith aksionereve ne perpjestim me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre.

Shoqeria nuk munde te ndaje dividend nese kapitalet e veta jane ose, si rrjedhoje e shperndarjes, do te beheshin me te vogla se shumet e kerkuara nga ligji.

## Neni 40

### Humbjet dhe mbartja e tyre

Pas miratimit te gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e pergjithshme, humbja e rezultuar ne nje vit financiar mbartet ne vitet pasues pe t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri ne shuarjen e humbjes.

Enllan Celaj

*[Signature]*

Devis Hoxhaj

*[Signature]*

Merita Plu

Robert Doko

*[Signature]*

## KAPITULLI VIII

### DETYRIME PER SEKRETIN E TE TJERA

#### Neni 44

##### Detyrimi per ruajtjen e sekretit

Anetaret e keshillit mbikqyres ,drejtori i pergjithshem si dhe te gjith personat e punesuar ne shoqeri dhe agjentet e saj , jane te detyruar te rujne fshehtesine e cdo informacioni qe marrin gjate kryerjes se detyrave ne shoqeri dhe te mos e perdorin ate per perfitime personale apo per te trete, si gjate kohes qe jane ne funksion ashtu edhe pas largimit te tyre.

Keshilli mbikqyres percakton rregulla dhe procedura me te hollesishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e permendur me siper si dhe per komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve te cilave kjo e drejte u eshte njohur me ligje



#### Neni 45

##### Detyrimi per te vene ne dispozicion te aksionereve dokumentat dhe informacionin

Shoqeria mbane dhe ve ne dispozicion te aksionereve , ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji,raportet,dokumentat dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te ndonje dokumenti te percaktuar nga asambleja, dokumentat qe duhet t u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen se bashku me njoftim-thirrjen per mbledhje

#### Neni 46

##### Detyrimi per te raportuar ne Komisionin e Mbikqyrjes se Sigurimeve

Raportimi ne Komisionin e Mbikqyrjes se Sigurimeve behet ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore per kete qellim. Dokumentat e kerkuara dergohen vetem me miaratinin e Drejtorit te Pergjithshem

*Arben Celaj* *Dimitris Hoxha* *Merita Alia*  
*Alim*  
*Robert Dado*  
*Beqir*



## KAPITULLI VI DEGET E SHOQERISE

### Neni 41

#### Statusi i deges

Dega e shoqerise eshte njesi organizative qe varet nga Drejtori i Pergjithshem. Dega e shoqerise krijohet ne baze rrethi ose rajoni dhe ka ne vartesi agjensi dhe zyra te shoqerise

### Neni 42

#### Drejtimi i deges se shoqerise, raporimet

Drejtimi dhe organizimi i deges ushtrohet nga drejtori i saj, i cili pergjigjet per gjith veprimtarine e deges ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi qe veprojne ne fushen e sigurimeve, urdherat dhe udhezimet e drejtorit te pergjithshem dhe dispozitat e ketij statuti.

Drejtori i deges ne perputhje me strukturen organizative dhe numrin e punonjesve te miratuar, emeron e shkarkon punonjesit dhe percakton pagat e tyre mujori, ne perputhje me tabelen e pagave te miratuar nga Keshilli i Mbikqyrjes.

Dega i dergon drejtorit te pergjithshem, ne afatet e caktuara prej saj, bilancin me relacionin shoqerues dhe evidencat e tjera statistikore, si dhe cdo informacion tjetër qe i kerkoher.



## KAPITULLI LIKUJDIMI

### Neni 43

#### Dispozitat e zbatueshme

Per kujdestarine si dhe per likujdimin e shoqerise ne rast prishjeje ose falimentimi zbatohen dispozitat e ligjit "Per sigurimet dhe per risigurimet", rregullat e percaktuara per kete qellim nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve si dhe ligjeve te tjera qe rregullojne keto gjendje

*Dritan Cetaj*     *Dennis Hoxha*     *Merita Alen*  
*Alen*     *Robert Doko*  
*Robert Doko*

**KAPITULLI V**  
**KONTABILITETI, GJENDJET FINANCIARE, KAKTIMI I REZULTATIT**

**Neni 38**

**Kontabiliteti, inventari gjendjet financiare**

Shoqëria mban kontabilitetin e saj në pajtim me ligjin "Per kontabilitetin" dhe me planin kontabel per shoqërite e sigurimeve

Ajo kryen një herë në 12 muaj inventarizimin e aktiveve dhe te pasiveve te saj, perpara se te pergatise gjendjen financiare vjetore.

Në mbyllje te cdo viti financiar, por jo me vonë se tre muaj nga data e mbylljes se vitit, shoqëria pergatite gjendjen financiare vjetore sipas rregullave te caktuara per kete qellim.

Viti financiar per te cilin pergatitet dhe publikohet gjendja financiare e shoqërise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.


**Neni 39**

**Rezultati financiar**


Rezultati financiar i shoqërise percaktohet në mbydhje te cdo viti si diference midis te ardhurave dhe shpenzimeve pasi te zbriten, gjithashtu, amortizimet dhe shumat e provigjioneve per zhvleresime dhe per rreziqe e shpenzime Rezervat per primet dhe rezervat per demet zbriten nga primet e sigurimit te vitit sipas rregullimeve perkatese ligjore dhe kjo realizohet perpare nxjerrjes se rezultatit.

Fitimi neto i shoqërise percaktohet pasi te zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur në menyre te perqendruar per shoqërine ne teresi.

*Dritan Çelaj*



*Demir Hoxhaj*



*Merita Plu*

*Robert Dado*  
*Bako*

Drejtori i Përgjithshëm, është i detyruar, që eksperteve kontrollues që paraqiten në shoqëri të pajtur me dokumenta sipas dispozitave ligjore, t'u vere në dispozicion për të kontrolluar të gjithë dokumentacioni e kërkuar prej tyre. Asnjë punonjes tjetër pa autorizim të drejtorit të përgjithshëm nuk e ka këtë të drejtë.

## AKSIONERET

1. DRITAN CELAJ

2. DERVISH HASKAJ

3. ROBERT DAKO

4. MERITA ALIU



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

TIRANE, me 27.11. 2000

Nr 540 Rep

Nr 281 Kol

## VERTETIM

Me ane të cilit vertetojme se aksioneret Dritan Celaj, Dervish Haskaj, Robert Dako dhe Merita Aliu e nënshkruan statutin e shoqërisë me vullnetin e tyre të lirë dhe në praninë time. Pas kësaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.

NOTE RJA

